



A.nr.253/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.253/2026, të datës 05.03.2026, të parashtruar nga ankuesi XH.D nga Mitrovica, në çështjen juridike-administrative “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 10.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa më numër A.nr.253/2026, e datës 05.03.2026, e parashtruar nga ankuesi XH.D.

A r s y e t i m

Ankuesi XH.D (*tutje referuar ankuesi*), përmes emailit ankesa.kpmsbck@rks-gov.net, më datë 05.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me Strukturën e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1163/2026 të datës 05.03.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Drejtori i Inspektoratit datë 01.06.2011; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.03.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 16.03.2026; Vendimin Ref.AUV,01-320/2018 të datës 05.09.2018; Emailin e datës 10.03.2026 nga M.SH për B.H; Emailin e datës 13.03.2026 nga E.M për M.SH.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e palejuar, sepse:

I. Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesi sipas Vendimit Ref. AUV, 01/320/2018, të datës 05.09.2018, ushtron pozitën *Koordinator i Zyrës Rajonale në Mitrovicë* në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se sipas strukturës organizative dhe sipas WEB faqes figuron një organogram ku jemi të eliminuar në Udhëheqësit e Rajoneve, ndërkohë është themeluar grupi punues për të draftuar një rregullore dhe nuk jemi njoftuar nëse e njëjtë është nënshkruar nga ish ministri dhe ministri i tanishëm. Mungon transparenca në këtë drejtim dhe shfaqja në WEB faqe është e kundërligjshme.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publika, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike*, ndërlidhur me nenin 124 paragrafi 1, ku përcaktohet: *“1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...”*, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesit është e papranueshme, ngase sipas shkresave të lëndës, nuk ka asnjë akt me të cilin konstatohet se ankuesit i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës si pasojë e Rregullores për Organizmin të Brendshëm.

Përkitazi me Rregulloren për Organizmin e Brendshëm siç pretendon ankuesi, Kolegji nga provat materiale të çështjes nuk ka gjetur se AUV ka të miratuar Rregullore për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në këtë institucion, përveç që, Njësia e Personelit të AUV ka ofruar njoftimin e draft rregullorja për organizmin e brendshëm të AUV-it është proceduar në MBPZHR. Andaj, mbi këto rrethana, rrjedhimisht duke qenë se ndaj ankuesit nuk ka ndonjë e veprim apo mosveprim të organit punëdhënës nga raport me ankuesin, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi nuk ka legjitimitetin e palës aktive në procedurë, kështu që, ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konsiderohet e pranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën

paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurës së Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji”.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.253/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, XH.D;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.